



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

2019
Nr. ___ prot.

Vlore me, 30/12/2024

VENDIM

Nr 24 datë 24/12/2024

"PËR MIRATIMIN E AKT-MARRËVESHJES MBI KUOTËN E
ANËTARËSISË PËR FINANCIMIN E BUXHETIT TË QARKUT NGA
BASHKITË"

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 38 pika 3, të Ligjit nr.9936, datë 02.06.2008 "Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012, "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" pika 121 i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. ___ datë ___.2024 "Për Miratimin e Planit të Buxhetit të vitit 2025, si dhe të vendimeve të këshillave bashkiakë "Për Miratimin e Planit të Buxhetit të vitit 2025",

VENDOSI

1. Të miratojë Akt-Marrëveshjen mbi kuotën e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Qarkut nga Bashkitë sipas lidhjes bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut dhe Sektori Financë, Buxhet dhe Shërbime.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 78 pika 3 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"

KRYETARI

ERVIS MOÇKA



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. ___ Prot, datë ___. __.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
Nr. _____ Prot dt _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Nr. _____ Prot dt _____

AKT - MARRËVESHJE

Mbi kuotën e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Qarkut

E lidhur sot në Vlorë, më datë _____ në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 38 pika 3, të Ligjit nr.9936, date 02.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të Udhëzimit nr.2, datë.06.02.2012, "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të buxhetit" pika 121; Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. _____ datë _____ "Për Miratimin e Planit të Buxhetit të vitit 2025, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. _____ datë _____ "Për Miratimin e Planit të Buxhetit të vitit 2025", midis palëve:

Bashkisë _____ përfaqësuar nga Z. _____, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë

dhe

Këshillit të Qarkut Vlorë, përfaqësuar nga Z.Ervis Moçka, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë.

Neni 1

Objekt i kësaj marrëveshje është derdhja e kuotës së njësisë vendore për llogari të Këshillit të Qarkut për vitin 2025, si dhe detyrimet e prapambetura.

Neni 2

Këshilli i Qarkut krijon të ardhura nga burimet e veta vendore përfshirë kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkisë, për kryerjen e funksioneve të veta dhe të përbashkëta.

Neni 3

Këshilli Bashkiak ushtron kompetencën dhe vendos për nivelin e kuotës së anëtarësisë të



detyrueshme për financimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut.

Neni 4

Kuota prej ____% qe korrespondon ne vleren ____ Leke për vitin 2024 është miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimin nr. ___, datë _____.2024, "Për Miratimin e Planit të Buxhetit të vitit 2025".

Neni 5

Kuota e miratuar nga Këshilli Bashkiak bëhet pjesë e buxhetit të njësive të qeverisjes vendore.

Neni 6

Mbi bazën e titullit për arkëtim që lëshon Sektori Ekonomik i Këshillit të Qarkut Vlorë, të rakorduar me degën e thesarit për të ardhurat e realizuara nga taksat dhe tarifat e njësisë vendore në baza tremujore, të bëhet transferimi i brendshëm, nga njësia vendore në favor të Këshillit të Qarkut.

Kjo akt – marrëveshje mbahet në 2 (dy) kopje, 1 prej të cilave mbahet nga Këshilli i Qarkut Vlorë, ndërsa 1 kopje nga Bashkia _____.

Pasi u lexua nga palët, me vullnet të lirë, u nënshkrua si më poshtë:

KËSHILLI I QARKUT VLORE

KRYETAR

Ervis MOÇKA

BASHKIA _____
